



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan, Republika e Kosovës

www.uni-gjiilan.net tel: 0280390112

Komisioni për Ankesa, i Këshillit të Fakultetit juridik , Universitetit "Kadri Zeka " në Gjiilan, në përbërje prej Fejzullah Hasani , kryetar , Liridon Dalipi dhe Ardian Emini_ anëtarë, në bazë të nenit 15 par. 1. të Rregullores mbi Procedurat e Angazhimit të Bashkëpunëtorëve të Jashtëm , në Universitetin Publik "Kadri Zeka " *Këshillit të Fakultetit Juridik*, i paraqet këtë:

R A P O R T

Në konkursin e shpallur nga Universitetit "Kadri Zeka" Ref. nr. 01/ 1125 Datë: 12/07/2022 , për angazhim përpos të tjerëve , kanë konkurruar edhe :

- 1.Mihrije Maloku-Morina , për bashkëpunëtoare, për mbajtjen e ushtrime në gjuhë angleze,
- 2.Emire Bilalli-Dermaku, bashkëpunëtoare për mbajtjen e ushtrime për lëndët ekonomike në fakultetin juridik ,
- 3.Bashkim Selmani , për " të gjitha lëndët juridike "

Komisioni Vlerësues , nuk i ka marr në shqyrtim aplikacionet e këtyre kandidatëve , për faktin se , në kundërshtim me konkursin , kanë dorëzuar dokumentacionet e fotokopjuara .

Sipas vlerësimit të Komisionit për ankesa , Komisioni Vlerësues, me të drejtë, nuk i ka marr në shqyrtim aplikacione e ankuesve , për faktin se ishin të pa kompletuara , ngas në faqen e fundit të konkursit, ka qenë e afishuar edhe kjo vërejtje : *Aplikacionet e arritura pas afatit, të pakompletuara, si dhe dokumentacionet me diploma të panostrifikuara nga MASHTI dhe të pa noterizuara nuk do të merren në shqyrtim. Të gjithë këta kandidatë , nuk e kishin plotësuar këtë kërkesë nga konkursi, ngase i kishin dorëzuar dokumentet e kopjuara dhe të pa noterizuara .*

Meqenëse këta aplikantë , nuk i kanë dorëzuar dokumentet e kërkuar me konkurs , të kompletuara/të noterizuara / , Komisioni, nuk u lëshua në meritat e ankesave dhe në këto rrethana, Këshillit të Fakulteti Juridik i ,

P R O P O Z O N

Që në mbështetje të nenit 15 të Rregullores mbi Procedurat e Angazhimit të Bashkëpunëtorëve të Jashtëm-Me Honorarë, ankesat e parashtruara t'i refuzoj si të pa bazuara.

ANËTARËT E KOMISIONIT:

1. Fejzullah Hasani , kryetar,

2. Liridon Dalipi, anëtarë,

3. Ardian Emini , anëtarë,

